



Organizata Jo-Qeveritare Emancipimi Civil Ma Ndryshe

## **TRASHËGIMIA KULTURORE DHE KULTURIZMI NË PRIZREN**

*Publikim i projektit “Forumet e Hapura Qytetare”*

Mars 2008, Prizren & Prishtinë



Organizata Jo-Qeveritare Emancipimi Civil Ma Ndryshe

Publikim i projektit "Formues e Hapur Qytete"  
KULTURIZIMI NË PRIZREN  
TRASHËGIMIA KULTURORE DHE

**Botues**

Organizata Jo-Qeveritare Emancipimi Civil Ma Ndryshe – EC Ma Ndryshe

**Financuar nga**

Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur – KFOS dhe  
Fondacioni Trashëgimia Kulturore pa Kufij - CHwB

**Dizajni, Ballina dhe Faqosja**

Granit Kallaba

**Shtypi**

Night Design Studio

**Tirazhi**

500 kopje

## **PËRMBAJTJA**

- Mbi këtë publikim
- Mbi projektin "Forumet e Hapura Qytetare"

### **PJESA 1 – Debatet**

- Disa të dhëna mbi debatet
- Debati 1 – "Ndërtim apo shkatërrim? Investimet në infrastrukturë të qytetit, rregullimi urbanistik dhe ruajtja e vlerave të qytetit"
- Disa konkluzione dhe opinione themelore të debatit
  
- Debati 2 – "Kujdes apo interes? Keqpërdorimi politik i trashëgimisë kulturore, zonat e mbrojtura dhe integrimi i minoriteteve
- Disa konkluzione dhe opinione themelore të debatit
  
- Debati 3 – Mbrojtje apo degradim? Trashëgimia kulturore e qytetit dhe kujdesi i tre-guar institucional dhe qytetar për të
- Disa konkluzione dhe opinione themelore të debatit
  
- Debati 4 – Mburje apo potencial? Trashëgimia kulturore e qytetit, vetëm si vlerë historike dhe qytetëruese, apo edhe potencial për zhvillimin ekonomik të qytetit (turizmi kulturor)
- Disa konkluzione dhe opinione themelore të debatit

### **PJESA 2 – Hulumtimi**

- Turizmi kulturor, mundësi për zhvillim lokal ekonomik
- Hulumtim mbi gjendjen e trashëgimisë kulturore dhe vlerësimin e potencialit për zhvillimin e turizmit kulturore në Prizren
- Metodologjia
- Analizë, përgjigjet e qytetarëve
- Përfundim

### **PJESA 3 - Analiza**

- Potenciali i zhvillimit të turizmit kulturor në Prizren - Kulturizmi
- Hyrje
- Koncepti i Kulturizmit (beneficioni i dyfishtë)
- Fakte rreth Kulturizmit
- Çka synohet? Si dhe çka do të përmirësohet?
- Përfituesit
- Përfundim
- Rekomandime
- Për qeverinë lokale
- Për shoqërinë civile
- Për komunitetin e biznesit
- Për qeverinë qendrore
- Për donatorët

## PÉRMBAKUN

- Miti kate publikim
- Miti projekti "Forum e Hapës Qytare"

### RIEZA 1 – Debatet

- Disa të dhëna mbi debatet
- Debat 1 – "Nëse investimet në infrastrukturë të qytetit, nëqytetit mund të na japin një pamje të qytetit?"
- Disa konkluzione dhe opinione themelore të debatit
- Debat 2 – "Kujdesi për interesin? Kërkime dhe opinionet e qytetarëve, zotë e opinionet dhe integrimi i minoritetëve"
- Disa konkluzione dhe opinione themelore të debatit
- Debat 3 – "Mbrojtja apo degradimi? Tërheqja e qytetarëve dhe kujdesi i tyre për infrastrukturën e qytetit për të"
- Disa konkluzione dhe opinione themelore të debatit
- Debat 4 – "Mbrojtja apo potenciali? Tërheqja e qytetarëve dhe vlerat e tyre historike dhe qytetare, apo edhe potenciali për zhvillimin ekonomik të qytetit (turizmi kulturor)"
- Disa konkluzione dhe opinione themelore të debatit

### RIEZA 2 – Hulumtimi

- Turizmi kulturor mund të zhvillojë lokal ekonomik
- Hulumtimi mbi qytetin e tërheqjes kulturore dhe vlerat e potencialit për zhvillimin e turizmit kulturor në Prizren
- Metodologjia
- Analiza, përgjigjet e qytetarëve
- Përfundimi

### RIEZA 3 - Analiza

- Potenciali i zhvillimit të turizmit kulturor në Prizren - Kulturizmi
- Hyje
- Koncepti i Kulturizmit (koncepti i dyfishtë)
- Fakte mbi Kulturizmin
- Çka synohet? Si dhe çka do të përmbledhet?
- Përfundimi
- Përfundimi
- Rekomandime
- Për qytetin lokal
- Për sipërmarrjen e qytetit
- Për komunitetin e Prizrenit
- Për qytetin përtej
- Për donatorët

## Mbi këtë publikim

Ky publikim është rezultat i projektit "Forumet e Hapura Qytetare", implementuar nga EC Ma Ndryshe në financim të Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS) dhe Fondacionit Trashëgimia Kulturore pa Kufij (CHWB). Qëllimi kryesor i projektit ishte nxitja e debatit për ndryshimin e qasjes ndaj pasurisë kulturore të qytetit të Prizrenit, me theks të veçantë në trashëgiminë kulturore të tij. Përmes serisë së debateve mbi kulturën dhe trashëgiminë kulturore të Prizrenit "Forumet e Hapura Qytetare" krijuan një hapësirë mjaft domethënëse komunikimi mes qytetarëve dhe vendimmarrësve lokalë, duke ngritur një mori çështjesh jetike për pasurinë kulturore dhe shpirtërore të Prizrenit. Pas debateve, të cilat u ndoqën me interesim shumë të madh dhe u transmetuan në televizion lokal, në kuadër të projektit u zhvillua edhe një hulumtim i opinionit të qytetarëve të Prizrenit mbi gjendjen e trashëgimisë kulturore të qytetit si dhe potencialin e zhvillimit të turizmit kulturor në këtë qytet. Turizmi kulturor ishte edhe tema e debatit të fundit në kuadër të "Forumeve të Hapura Qytetare", përmes të cilit u plasua idea kryesore që qëndronte pas tendencave të shumta të EC Ma Ndryshes dhe organizatave partnere për të promovuar potencialin turistik që posedon Prizreni. Për shkak të natyrës mjaft specifike të pasurive që posedon, turizmi kulturor paraqet një potencial shumë të rëndësishëm zhvillimor për qytetin. Pasuritë dhe vlerat kulturore të qytetit të Prizrenit janë potencial mjaft i çmueshëm për t'i dhënë dimension turistik zhvillimit lokal ekonomik të qytetit. Përgjatë këtij projekti si dhe në këtë publikim, tema e turizmit kulturor është diskutuar në serinë e debateve, hulumtimin e opinionit si dhe në analizën e titulluar Potenciali i zhvillimit të turizmit kulturor në Prizren "Kulturizmi" (shih pjesën e fundit të publikimit).

Ky publikim nuk do të ishte i mundur pa ndihmën e pakursyer të partnerëve dhe donatorëve tanë. Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS) ka qenë mbështetësi kryesor financiar i këtij projekti dhe publikimi, prandaj edhe i shprehim falënderimet tona më të sinqerta për ndihmën që i'a kanë ofruar organizatës sonë, si dhe nxitjes së parimeve të shoqërisë së hapur në tërë Kosovën. Në të njëjtën kohë, përkrahja e Fondacionit Trashëgimia Kulturore pa Kufij (CHWB) si në aspektin financiar ashtu edhe në implementim të drejtpërdrejtë të projektit "Forumet e Hapura Qytetare", ka qenë mbështetje esenciale për arritjen e rezultateve të dëshiruara të këtij projekti. Përvoja dhe ekspertiza e CHWB-së ka qenë dhe mbetet udhërrëfyese e aktivitetit të EC Ma Ndryshes, në fushën e trashëgimisë kulturore.

## Mbi projektin "Forumet e Hapura Qytetare"

Fenomeni i ndërrimit të identitetit të qytetit po ndodh. Investimet në infrastruktura të qytetit të Prizrenit (rrëzimet, ndërtimet, asfaltimet, betonimet, etj.) po bëhen pa u marrë edhe aq shumë parasysh trashëgimia kulturore e qytetit dhe nevoja për mbrojtje dhe promovim të kësaj trashëgimie. Derisa plani urbanistik i qytetit është ndërtuar vetëm mbi parimin e ekspertizës së personave të caktuar, në anën tjetër nuk po ndodh debati dhe konsultimi me qytetarë. Problemi del të jetë i dyanshëm, mungesa e mekanizmave efektivë të konsultimit me qytetarë, por edhe mosinteresimi i qytetarëve për të marrë pjesë dhe ndikuar në vendimmarrjen lokale. Si pasojë, përjetojmë zgjerim të hapësirës së moskomunikimit mes qeverisë lokale dhe qytetarëve, situatë e cila po krijon dy realitete të ndara nga njëri-tjetri në Prizren. Në këtë rreth, debati dhe nxitja e tij bëhen nevoja urgjente të kohës. Krijimi dhe promovimi i kulturës së debatit është parakusht themelor i inicimit të partneritetit afatgjatë mes qeverisë lokale dhe qytetarëve në drejtim të krijimit dhe implementimit të politikave dhe projekteve me interes të përgjithshëm në qytetin e Prizrenit.

Pas një serie të debateve të nivelit të lartë dhe të përgatitura gjatë në Prizren, të cilat u transmetuan në televizione lokale dhe kombëtare, EC Ma Ndryshe arriti që të stimulojë debat publik mbi çështjen e mbrojtjes dhe promovimit të trashëgimisë kulturore në Prizren. Debatet siguruan pjesëmarrje të panelistëve të nivelit më të lartë, duke tërhequr vëmendjen e një audience të gjerë, të përbërë nga qytetarë të Prizrenit të moshave, nivelit të edukimit dhe profesioneve të ndryshme. Rëndësi e veçantë i'u kushtua efektit shumëzues të debateve, në mënyrë që të përcillen nga masat e gjera të qytetarëve. Për të arritur këtë, të gjitha debatet janë transmetuar në TV (Radio Televizioni i Kosovës dhe TV Opinion) për së paku katër ose pesë herë gjatë periudhës së implementimit të projektit, derisa ueb-faqja e EC Ma Ndryshes ka ofruar informata të freskëta mbi debatet e përfunduara.

Përmes këtij projekti, EC Ma Ndryshe ka krijuar një model të suksesshëm të forumeve qytetare, ku secili mund të vijë dhe të debatojë drejtpërdrejtë me personat përgjegjës si dhe të dëgjojë opinionet e ekspertëve, shoqërisë civile dhe shqetësimet tjera me të cilat ballafaqohen qytetarët. Kjo formulë e të debatuarit mbi çështje të rëndësishme doli të jetë mjaft efektive, duke stimuluar diskutime të gjata në qarqe të ndryshme qytetare dhe duke i nxitur vendimmarrësit lokalë që të ndërmarrin hapa konkretë për përmirësimin e gjendjen në këtë sektor. Shumica e pjesëmarrësve në debate konfirmuan mungesën dhe nevojën urgjente për të pasur instrumente (forume) të këtilla si mënyra mjaft efektive të promovimit të kulturës së debatit që mungon në Prizren dhe ndikimit tek vendimmarrësit lokalë dhe qendrorë.

Element tjetër mjaft esencial i këtij projekti ishte edhe hulumtimi i opinionit publik mbi trashëgiminë kulturore të qytetit dhe potencialin e zhvillimit të turizmit kulturor në Prizren. Hulumtimi nxori të dhëna relevante mbi mënyrën se si qytetarët e mendojnë dhe e perceptojnë gjendjen, mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë

kulturore të Prizrenit. Qytetarëve, por në veçanti grupeve të ndryshme të komunitetit (bizneset, shoqëria civile, qeveria lokale) i'u mat edhe niveli i gatishmërisë për të qenë pjesë integrale e promovimit të turizmit kulturor në Prizren.

Rezultatet tjera të arritura të këtij projekti përfshijnë: rritja e komunikimit mes qytetarëve dhe qeverisë lokale, rritja e vetëdijes qytetare për një qasje alternative ndaj trashëgimisë kulturore të qytetit (turizmi kulturor), arritja e një audience mjaft të gjerë përmes transmetimit të debateve në TV kombëtare dhe lokale, tërheqja e vëmendjes së publikut të gjerë mbi keqpërdorimet dhe degradimin që po i bëhet objekteve dhe vlerave të trashëgimisë kulturore të Prizrenit, dhënia e pasqyrës preeliminare mbi perceptimet e qytetarëve për trashëgiminë kulturore, etj.

te dani tessa integrals e gramovinit te dazmit kultur, no pater  
tint (pizneset, stoperis ovis, devens lokals) fu mar edis nivel i gatisinras per  
kulture te frizentit. Oytatave, por us vegant grupe te ndajras te komu-

gac pater tes te amtra te kati pateri pashinor, mta e komunikant tes dy  
tataru, des devens lokals, mta e vafdes dytate per nje dasje slemstive nosi  
tashpase kulture te dylem (tuzem kulture), sinta e nje audence mair te  
gac pater transformit te debatare ne TV kompare dte lokals, femija e ve-  
mendur te quilit te gite mti kedpeshant dte dte dte dte dte dte dte dte dte  
tektore dte vlera te tashpase kulture te frizentit, dte dte e pasqyre  
gac pater mti pashinor e dytatave per tashpase kulture, etj.



## **PJESA 1 - Debatet**

### **Disa të dhëna mbi debatet**

Katër debate janë organizuar gjatë periudhës Tetor – Nëntor 2007. Edhe pse në fillim ishin planifikuar të mbahen gjashtë debate, Zgjedhjet Qendrore dhe Lokale në Kosovë, të cilat u caktuar që të mbaheshin më 17 Nëntor 2007, ndikuan në marrjen e vendimit për uljen e numrin të debateve, në mënyrë që të evitohet interferimi me fushatën zgjedhore, vakumin institucional dhe humbjen e interesimit për debate shkaku i agjendës zgjedhore. Debatet u moderuan nga moderatorë profesionistë: Agron Krasniqi i Radio Televizionit të Kosovës (debatet 1 dhe 2) dhe Blerim Myftiu i Koha Vizionit (debatet 3 dhe 4). Radio Televizioni i Kosovës ka transmetuar debatin e parë, derisa TV Opinion (televizion lokal i Prizrenit, me shikueshmëri në tërë rrafshin e Dukagjinit) të gjitha debatet tjera.

Më poshtë, të përmbledhura janë detalet teknike si dhe konkluzionet kryesore që dolën nga debatet.

### **Debati 1**

#### **Tema**

Ndërtim apo shkatërrim? Investimet në infrastrukturë të qytetit, rregullimi urbanistik dhe ruajtja e vlerave të qytetit

#### **Data, vendi**

6 Tetor 2007, Prizren

#### **Panelistë**

Mybera Mustafa (Kryeshefe e Ekzekutivit, Kuvendi Komunal i Prizrenit), Edi Shukriu (Arkeologe dhe Profesoreshë universitare), Aranit Ukimeri (UD i Drejtorit të Drejtorisë për Komunikacion dhe Lidhje, Kuvendi Komunal i Prizrenit), Sali Shoshaj (Drejtor Ekzekutiv i CHwB, Zyra në Prishtinë), Rudina Bukoshi (Zyrtare e Rinisë në Kuvendin Komunal të Prizrenit dhe Deputete e Kuvendit të Kosovës), Jeton Jagxhiu (aktivist dhe njohës i çështjeve kulturore, qytetar i Prizrenit)

#### **Audienca**

Rreth 50

### **Disa konkluzione dhe opinione themelore të debatit**

**Mybera Mustafa:** Sipas kryeshefes Kuvendi Komunal i Prizrenit nuk ka përgjegjësi për Trashëgiminë Kulturore, ku ajo cek se me rregulloren 2000/45 dhe Ligjit të Trashëgimisë Kulturore, Kuvendet Komunale nuk obligohen për mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore dhe se kjo e drejtë është e rezervuar për Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Gjithashtu Kryeshefja thekson se Ministria nën kompetenca të veta ka Institutin për Mbrojtjen e Monumenteve dhe se ky institucion merret me mbrojtjen, promovimin, dhënien e lejeve për ndërtim si dhe rekomandimin për rrënimet e objekteve të vjetra. Mybera Mustafa cek faktin se në bashkëpunim mes MKRS-Institutit për Mbrojtjen e Monumenteve dhe Kuvendit Komunal duhet të kishin formuar Këshillin për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore. Gjithashtu Znj. Mustafa thekson se kompetencat për Trashëgiminë Kulturore janë ekskluzive të MKRS-së dhe se Këshilli i lartpërmendur për Trashëgiminë Kulturore ende nuk është formuar dhe këtë funk-

sion tani për tani e kryen Divizioni për Trashëgiminë Kulturore në MKRS. Për vendimet e marra nga Kuvendi Komunal, Znj. Mustafa thotë se çdo vendim i cili miratohet nga ky organ fillimisht del në diskutim me qytetarë e pastaj vendoset për të, për arsye se kështu obligon ligji. Në diskutime me panelistët tjerë Znj. Mustafa theksoi se plani i konservimit për ne është i rëndësishëm por për ta miratuar atë tani për tani mungon infrastruktura ligjore. Për rrënimin e ndërtesës së Beledies Kuvendi Komunal ka marr miratimin nga Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve. Gjithashtu Znj. Mustafa falënderoi Iniciativën për Kinemanë, ku nga peticioni për mos ndërrimin e destinaconit KK e ka marr shumë seriozisht dhe po punojnë që në atë vend të ketë prapë kinema.

**Edi Shukriu:** Prizreni qytet i vjetër me vlera të shumta të trashëgimisë kulturore, fatkeqësisht nuk është i mbrojtur nga UNESCO-së siç është p.sh Ohri. Prizreni ka një infrastrukturë të nevojshme për t'u bërë pjesë e familjes së UNESCO-së, mirëpo një akt i tillë ende nuk ka ndodhur. Përpjekjet për ta bërë Prizrenin të mbrojtur nga UNESCO datojnë që nga 1960, gjithashtu pas luftës së fundit ka pasur disa përpjekje në këtë drejtim mirëpo pa ndonjë sukses. Aktualisht ngjarjet që po ndodhin në Prizren , shkatërrimet, rrënimet, mos-mirëmbajtja e vlerave të trashëgimisë kulturore etj. po e largojnë Prizrenin nga familja e UNESCO-së.

Prizreni gradualisht po e humbë frymën e qytetit të vjetër. I tmerrshëm është fakti se po shkatërrohen objektet e vjetra me vlera të mëdha të trashëgimisë kulturore. Sensibilizimi i qytetarëve për mbrojtjen e trashëgimisë me herët ka qenë më i madh,



p.sh në rastin kur vërshimet rrënuan Urën e Gurit dhe ku qytetarët me vetiniciativë duke mbledhur gur në lumin Lumbardh kthyen urën pothuajse në gjendjen se si ka qenë me herët. Në pyetjen e bërë nga moderatori se sa i plotëson kriteret Prizreni për të qenë pjesë e UNESCO-s, profesoresha Shukriu u përgjigj: Me një menaxhim më të mirë ka mundësi, por këto mundësi janë të vogla dhe një menaxhim i mirë dhe i suksesshëm nga Pushteti Lokal mund ta shpëtojë Prizrenin dhe të bëjë atë pjesë të UNESCO-së. Profesoresha Shukriu ceku faktin se në vitin 1972 Prizreni ka qenë i nominuar për të qenë pjesë e UNESCO-së dhe shton se strukturat e atëhershme kanë punuar me mund të madh që Prizrenin ta bëjnë të mbrojtur nën UNESCO.

Periudhën e pasluftës në profesoresha e paraqet si alarmante për Trashëgiminë Kulturore, ku jo se vetëm nuk u mbronte dhe promovonte Trashëgimia Kulturore por dolën në skenë edhe shumë ekspertë të kësaj fushe pa qenë fare të kualifikuar apo të kenë pasur përvojë të mëhershme në këtë fushë. Këta ekspertë të vetquajtur i sollën dëme të mëdha Trashëgimisë Kulturore në Kosovë, në veçanti në qytetin e Prizrenit. Gjithashtu profesoresha Shukriu theksoi faktin se mjetet materiale të cilat planifikohen nga MKRS-ja për Trashëgiminë Kulturore nuk ndahen në mënyrë të drejtë dhe se ka keqpërdorime të shumta. Gjithashtu, Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve kohëve të fundit në mënyrë shumë të lehtë po jep leje të ndërtimit edhe në zonat ku më herët ishte e ndaluar të ndërtohet apo shkatërrohet ndonjë objekt. Objektet e vjetra me vlera kulturore për qytetin dhe për tërë Kosovën nuk mirëmbahen si duhet apo nuk mirëmbahen fare (p.sh. Muzeu Arkeologjik në Prizren). Apeli i profesoreshës Shukriu për qytetarët dhe pushtetin lokal të Prizrenit ishte "Trashëgiminë Kulturore mos ta politizojmë. Ajo të mbrohet dhe të promovohet dhe për të të ndihet dashuri dhe respekt".

**Aranit Ukimeri:** Duke folur për planin urbanistik të qytetit tha: Gjatë periudhës kur plani urbanistik është konsultuar me qytetarë, shumë qytetarë dhe Organizata Jo-Qeveritare kanë dhënë opinionet e tyre për planin urbanistik të qytetit. Ky plan është miratuar konform të gjitha procedurave ligjore, shtoi z.Ukimeri. Gjatë planit urbanistik ekspertë të Trashëgimisë Kulturore në Kuvendit Komunal të Prizrenit kanë dhënë vlerësimet dhe sygjerimet e tyre lidhur me këtë fushë, ku këto vlerësime dhe sygjerime janë marrë parasysh nga Kuvendi Komunal. Trashëgimia Kulturore pas luftës ka qenë në gjendje të rëndë dhe të gjithë ju të pranishmit e dini këtë fakt theksoi z. Ukimeri, por në qytet edhe trafiku është tepër i ngarkuar dhe duhet krijuar infrastrukturë për lëvizje të lirë. Në qytet ka më tepër se 40.000 automjete dhe për të lehtësuar dhe përballuar këtë trafik ne duhet të krijojmë infrastrukturë të re. Në pyetjen e bërë nga moderatori se a duhet të rrënohen objekte të vjetra me vlera të mëdha kulturore për tu ndërtuar kjo infrastrukturë, p.sh kinemaja e qytetit. Përgjigja e z. Ukimeri ishte se duhet krijuar parakushte për lëvizje të lirë. Në pyetjen tjetër të bërë nga audienca lidhur me mirëmbajtjen e monumenteve dhe objekteve tjera me vlera të shumta kulturore, z. Ukimeri shtoi se në bazë ligjit Trashëgimia Kulturore është kompetencë e MKRS dhe se çdo gjë që bëjmë në ruajtjen dhe promovimin e këtyre objekteve është në aspektin moral se përndryshe nuk hyn në kompetencat tona. Në pyetjen tjetër nga audienca, se kur Kuvendi Komunal do të ndërrojë më-

nyrën e punës, që fillimisht të konsultohen qytetarët e pastaj të rrënohen objektet (p.sh objekti i Komunës). Në këtë pyetje përgjigja e z. Ukimeri ishte se Kuvendi Komunal i Prizrenit në bazë të ligjit merr çdo vendim, si e përcakton ligji ashtu edhe ne vendosim.

**Rudina Bukoshi:** Para fillimit të fjalimit znj. Bukoshi tha se në këtë takim/debat është dashur të thirret edhe dikush nga MKRS-ja, pasi që kjo fushë është kompetencë e kësaj ministrie. Moderatorin në pyetjen drejtuar znj. Bukoshi se çka konkretisht ka bërë Komuna për Trashëgiminë Kulturore, znj. Bukoshi theksonte se Komuna ka bërë shumë në këtë fushë. Edhe pse hezitoi ti përmendte rastet në të cilat KK konkretisht ka vepruar për mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore, pas insistimit nga moderatorin, znj. Bukoshi përmendi rastin e pastrimit të Hamamit të Prizrenit në vitin 2000. Por lidhur me këtë çështje reagoi një pjesëmarrës nga audienca ku tha se këtë vepër e ka bërë IRC në bashkëpunim me Qendrën Rinore të Prizrenit e jo Kuvendi Komunal siç pohonte znj. Bukoshi.

**Jeton Jagxhiu:** Sipas z. Jagxhiu vitet e pas luftës kanë qenë vite të degradimit më të madh për qytetin e Prizrenit, si p.sh. Rrënimi i Urës nga drejtorja për urbanizëm dhe ndërtimi i një ure moderne, Rrënimi i objektit të Beledies, Tentime për heqjen e ditës së Pazarit, Tendencë për rrënimin e Kinemasë etj. Sipas z. Jagxhiu, pushteti lokal është i menaxhuar nga njerëz që nuk njohin vlerat e qytetit, ku kryetari i Komunës vet është gjenerator i krizave në qytet. "Prizreni gjithmonë ka qenë modern, por modern me vlerat e veta të kulturës edhe të trashëgimisë kulturore." Z. Jagxhiu shprehu shqetësimin se Kuvendi Komunal për vendimet që po merr nuk po konsulton fare me qytetarët. Plani urbanistik i miratuar nga komuna nuk është konsultuar me qytetarë, ndërsa ata pak qytetarë dhe shoqëri civile të cilët kanë dhënë opinionet e tyre nuk janë marr parasysh nga Komuna. Kuvendi Komunal konkretisht ka parë boshllëqe në keqpërdorimin dhe keqmenaxhimin e pronës publike dhe ato boshllëqe po i përdor me shumë sukses. Sipas Z. Jagxhiu Kuvendin Komunal të Prizrenit e udhëheqin njerëz jo të duhur dhe të pa aftë. Kuvendi Komunal ka keqpërdoruar rolin e vet "ne vend se të jetë shërbyes për qytetarët, ata janë zotërues". Z. Jagxhiu si qytetar i thjeshtë shprehi shqetësimet e tij lidhur me ndërtimet dhe shkatërrimet që po ndodhin në qytetin e Prizrenit, dhe theksoi se jo vetëm ai, por një pjesë shumë e madhe e qytetarëve janë tepër të shqetësuar lidhur me atë se çka po ndodh në qytet.

**Sali Shoshaj:** Pas luftës së Dytë Botërore në Evropë është zhvilluar një debat i madh lidhur me modernizimin e Evropës. Nga ky debat kanë dalë edhe shumë deklarata lidhur me mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore. Këto deklarata janë nxjerrë si arsye për mbrojtjen dhe promovimin ku Evropa e re do të ndërtohej mbi këto baza. Sipas z. Shoshaj Komuna ka përgjegjësi për Planin Urbanistik të qytetit. Ky plan urbanistik nuk e rregullon çështjen e Trashëgimisë Kulturore të Prizrenit për arsye se kjo çështje nuk është marrë parasysh. Plani për Konservim i bërë nga shumë organizata dhe institucione vendore dhe ndërkombëtare nuk është miratuar nga komuna.

Ligji për Trashëgiminë Kulturore është kompetencë e MKRS mirëpo për identifikimin e zonave historike dhe zonave të mbrojtura duhet bashkëpunim në mes MKRS-Kuvendit Komunal dhe Ministrisë së Planifikimit Hapësinor. Ky bashkëpunim brenda këtij trekëndëshi mungon. Gjithashtu z. Shoshaj shton se në Kuvendin Komunal të Prizrenit mungojnë ekspertë të kësaj fushe, dhe se faji po mbetet diku në ajër për arsye së MKRS-ja dhe Kuvendi Komunal po ja hedhin fajin njëra tjetrës.

Në vitin 2005, brenda zonës ka pasur 1645 ndërtesa të reja, kurse para Luftës së Dytë Botërore në këtë zonë kishte vetëm 660 ndërtesa apo 40%. Gjithashtu z. Shoshaj theksoi se objekte historike nuk janë vetëm ndërtesat e vjetra por edhe rrugicat, krojet, fasadat, kulmet, kalldrëmi etj. Lidhur me pyetjen nga moderatori se a i plotëson Prizreni kriteret e UNESCO-së, z. Shoshaj tha: Me një menaxhim më të mirë ekzistojnë shanse por këto shanse tanimë janë të pakta. Në komentin nga kryeshefja lidhur me ndërtesën e Beledies se gjysma ka qenë e shkatërruar dhe se ne e kemi shkatërruar për atë arsye, si përgjigje për këtë koment z. Shoshaj theksoi se në zonën e mbrojtur gjithçka është e mbrojtur qoftë edhe një karrige e thjeshtë.

## Debati 2


<b>Tema</b>	Kujdes apo interes? Keqpërdorimi politik i trashëgimisë kulturore, zonat e mbrojtura dhe integrimi i minoriteteve
<b>Data, vendi</b>	20 Tetor 2007, Prizren
<b>Panelistë</b>	Ergjan Shpat (Zëvendës Kryetar i Kuvendit Komunal të Prizrenit), Skënder Boshtrakaj (Udhëheqës i Zyrës për Integritim Evropian, MKRS), Fatmir Pireci (Udhëheqës i Zyrës për Informim Publik, Kuvendi Komunal i Prizrenit), Parim Kosova (Drejtor i Muzeut të Lidhjes së Prizrenit)
<b>Audienca</b>	Rreth 50

### **Disa konkluzione dhe opinione themelore të debatit**

**Skender Boshtrakaj:** Shumë probleme në Kosovë janë probleme të mëdha por nuk debatohet për ato. E bukura e Organizatës Jo-Qeveritare EC Ma Ndryshe është se institucionalizon këtë temë, tërheq debatin nga jashtë në një forum të organizuar për diskutim.

Mungesa e ciceronit në Prizren një problem shumë i theksuar, pasi që me vizitorët që unë vijë në Prizren duhet të luaj rolin edhe të ciceronit. Mungesa e informacionit për Trashëgiminë Kulturore të Prizrenit gjithashtu është një problem tjetër që një-rëzit ballafaqohen.

**Ergjan Shpat:** Vetë fakti se për herë të dytë po bisedojmë për Trashëgiminë Kulturore në Prizren është një hap përpara për promovimin e Trashëgimisë Kulturore të Prizrenit. Ndoshta vonë po debatojmë për Trashëgiminë Kulturore por shpresojë të jenë të mirëseardhura këto debate për të gjithë ne. Kuvendi i Komunës i ka mundësitë e kufizuara për ndërhyrje në Trashëgiminë Kulturore. Objektet të cilat janë nën mbrojtje janë edhe nën mbikëqyrjen e Institutit për Mbrojtjen e Monumenteve në Prizren. Për arsye të mungesave buxhetore nga Kuvendi Komunal i Prizrenit nuk kemi edhe ciceron, pasi që buxheti ynë nuk e parasheh një të tillë. Nuk pranoj se janë



duke u shkatërruar objektet e Trashëgimisë Kulturore, pra Aneksi i Beledies nuk ishte nën mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore, Objekti i Kinemasë është komunist dhe nuk i përket Trashëgimisë Kulturore dhe besoj se objekti i Kinemasë është politikisht i përdorur në këtë periudhë.

**Parim Kosova:** Shkatërrimi i objekteve të Trashëgimisë Kulturore daton më herët. Edhe para dhe gjatë luftës janë shkatërruar shumë objekte. Deri në vitin 2003 Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve para se të merrte vendim për dhënien e lejes për ndërtim në zonën e mbrojtur kërkonte leje edhe nga ne, por që nga viti 2003 një gjë e tillë nuk ndodh më. Procedura për të marr leje për ndërtim në zonën e mbrojtur fillon nga Instituti por shkon për miratim nga drejtoria për Urbanizëm në Kuvendin Komunal. Shumë drejtorë në Kuvendin Komunal janë ndër-ruar por kurrë nuk janë marrë në pyetje për shkatërrimin e Trashëgimisë Kulturore në Prizren.

**Ergjan Shpat:** Objekti i Namasxhahut është ndërtuar nga Kuvendi Komunal i Prizrenit. Për restaurimin e xhamisë së Sinan Pashës Kuvendi Komunal ka siguruar 1.3 milion Euro. Lejet për ndërtim janë dhënë konform planit urbanistik të qytetit. Të gjitha lejet që janë dhënë janë dhënë me pëlqimin e Institutit, nuk ekziston asnjë leje për të cilën Instituti nuk ka informacion.

**Fatmir Pireci:** Kuvendi Komunal është angazhuar në mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore në Prizren. Kuvendi Komunal, respektivisht Inspektorati i Kuvendit Komunal ka ndaluar ndërtimet në shtëpinë e vjetër të Ymer Prizrenit. Vullneti i mirë i kryetarit të Kuvendit Komunal na ka shtyrë që të bëjmë ofertë për të blerë shtëpinë e vje-

tër të Shehzades. Tash më ne iu kemi bërë ofertën dhe presim përgjigjen. Por ne si Kuvend Komunal kemi limitime buxhetore dhe për atë arsye angazhimi i ynë është i limituar.

**Skender Boshtrakaj:** Si arsye e ndodhive tragjike në vitin 2004 Trashëgimia ka qenë prioritet për MKRS-në. Kuvendi Komunal i Prizrenit po duket se është menaxher i dobët sa i përket Trashëgimisë Kulturore. Mbrojtje të Trashëgimisë Kulturore automatikisht do të nënkuptohej edhe mbrojtja e qytetit. Standardet për mbrojtjen dhe promovimin e Trashëgimisë Kulturore i takojnë komunës, nuk është ky fakt i kompetencave të ministrisë por është diçka që vjen nga komuna. Prizreni është një qytet i cili ka potencial për zhvillimin e turizmit kulturor, por nëse e degradojmë në këtë mënyrë kulturën dhe trashëgiminë kulturore atëherë Prizreni mund të mbetet edhe pa atë potencial. Duhet gjithashtu të ndodh depolitizimi i Trashëgimisë Kulturore, të mbahet larg politika nga trashëgimia.

**Fatmir Pireci:** Për Prizrenin Trashëgimia Kulturore është pasuri. Ne si Kuvend gjithmonë insistojmë në sensibilizimin e qytetarëve në mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore. Rindërtimi i urës nuk e ka bërë që ura të ketë pamje tjetër arkitektonike, pamja ka mbetur e njëjtë.

**Parim Kosova:** Që nga mbarimi i luftës e deri në ditët e sotme nga instituti janë dhënë 400 leje për ndërtim.

**Fatmir Pireci:** Kuvendi Komunal ka pasur disa iniciativa për të ndërtuar Nënkanalë, por një gjë nuk ka ndodhur pasi që me kërkesën e peshkopit të Rashkës janë ndaluar punimet. Ura e Suzit ka qenë një objekt demode këtë e ka thënë edhe profesori Walltershyler i cili e ka konstatuar këtë objekt për rrënim. Kuvendi Komunal që nga viti 2000 ka në mandat që të ofrojë vetëm mbështetje logjistike e jo për të marrë hapa tjerë. Nëse edhe administrata tjetër do të udhëhiqet me Rregulloren 2000/45 do të ketë duart e lidhura lidhur me intervenimet konkrete në mbrojtjen dhe promovimin e Trashëgimisë Kulturore.

**Parim Kosova:** Le të shikojmë arkivat e Televizionit Opinion edhe të shohim nëse po ashtu ka thënë profesori. Unë nuk besoj të ketë thënë në atë mënyrë, për të shkatërruar një objekt të vjetër është njëjtë sikur të ja marrësh jetën dikujt.

**Ergjan Shpat:** Kuvendi Komunal ka arritur të marrë donacion nga Qeveria e Turqisë për rindërtimin e xhamisë së Sinan Pashës, dhe kjo tanimë po ndodh. Objektet tona Historike dhe fetare janë të gjithëve nuk ka dallime se ato i përkasin atij grupi etnik kurse tjerat i përkasin grupit tjetër etnik, pra të gjithë objektet historike dhe fetare iu takojnë të gjithë qytetarëve pa dallime.

**Parim Kosova:** Trashëgimia Kulturore i takon Prizrenit, por për disa arsye disa objekte po privilegjohej si puna e Kishës Ortodokse që është publikuar në atë fle-

tushkë që ka bërë Komuna. Broshura e bërë nga Komuna privilegjon vetëm njërin nga komunitetet.

**Skender Boshtrakaj:** Në dokumentin Standardet për Kosovën vërehet se shkruan që Trashëgimia Kulturore është e të gjithë qytetarëve pa dallim feje, etniteti etj. Objektet fetare ortodokse kanë qenë shumë aktive nga dora e politikës së Beogradit, jo vetëm ndodhitë e Marsit 2004. Ngjarjet e vitit 2004 i kanë kushtuar shumë Kosovës. Trashëgimisë Kulturore Ortodokse iu është vënë mbiemri Serb. Statusi i pa-  
definuar gjithsesi ka lënë shumë çështje të varura peng.

**Ergjan Shpat:** Lidhur me sheshin e Shatërvanit Kuvendi Komunal është në bisedime me AKM-në për Shtëpinë e Mallrave dhe jemi duke diskutuar çështjet se si Komuna ta merr në pronësi këtë objekt.

### Debati 3

#### Tema

Mbrojtje apo degradim? Trashëgimia kulturore e qytetit dhe kujdesi i treguar institucional dhe qytetar për të

#### Data, vendi

27 Tetor 2007, Prizren

#### Panelistë

Bashkim Fehmiu (arkitekt dhe planifikues urban, Profesor universitar),  
Burbuqe Deva-Bakija (Udhëheqëse e Divizionit për Trashëgimi Kulturore, Departamenti i Kulturës, MKRS), Shafi Gashi (arkeolog),  
Habib Ahmeti (Drejtor i Institutit për Mbrojtjen e Monumenteve Historike, Prizren)

#### Audienca

Rreth 60

### **Disa konkluzione dhe opinione themelore të debatit**

**Burbuqe Deva:** MKRS nuk merret me mbrojtjen e objekteve të Trashëgimisë Kulturore, por përcakton politikat e përgjithshme zhvillimore. Futja e një objekti nën mbrojtje është detyrë jo e lehtë institucionale. Lista e objekteve për mbrojtje është





jo e qëlluar pasi që ka objekte që nuk e meritojnë të futen nën mbrojtje. Faktori njeri është faktor mjaft diskutativ i Trashëgimisë Kulturore. MKRS ka bërë plane për vetëdijesimin e qytetarëve për mbrojtje. Mungesa e buxhetit adekuat është faktor i rëndësishëm i mbrojtjes së Trashëgimisë Kulturore.

**Habib Ahmeti:** Institucionet për mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore kanë qenë zhvillim normal i rrethanave.

**Bashkim Fehmiu:** Institucioni është zhvillim i vonshëm, ka mungesë të konsiderueshme të debatit. Puna e institucioneve shihet nëse bëjmë një shëtitje nëpër qytet. Nuk kemi prej kujt t'i mbrojmë këto objekte, vetëkuptueshmërisht janë të mbrojtura. Plani i Çarshisë Arasta është më 1962. Është jologjike që Ligji për Trashëgiminë Kulturore ka pritur 4 vite për miratim. Nuk ka buxhet që nuk gjenerohet, por mbrojtja e Trashëgimisë Kulturore është burimore.

**Shafi Gashi:** Ekziston mungesa e legjislacionit për Trashëgimi Kulturore dhe Arkeologji. Pas luftë në Prizren kishte një vërshim demografik, prandaj kemi raste kur të ardhurit nga zonat rurale nuk i kishin parasysh vlerat e Trashëgimisë Kulturore. Kuvendi Komunal i Prizrenit duhet të ketë rol më të theksuar në mbrojtje të Trashëgimisë Kulturore. Prej viti 1945 vetëm 5 shtëpi janë futur nën mbrojtje institucionale dhe ligjore në Prizren.

#### Debati 4

##### Tema

Mburrje apo potencial? Trashëgimia kulturore e qytetit, vetëm si vlerë historike dhe qytetëruese, apo edhe potencial për zhvillimin ekonomik të qytetit (turizmi kulturor)

##### Data, vendi

2 Nëntor 2007, Prizren

##### Panelistë

Veton Nurkollari (Drejtor artistik i Festivalit Dokufest), Halil Bajrami (Udhëheqës i Departamentit të Turizmit, MTI), Jeta Limani (CHWB Zyra në Prishtinë), Fatmir Pireci (Udhëheqës i Zyrës për Informim Publik, Kuvendi Komunal i Prizrenit), Refet Bushati (Shoqata e Zejtarëve Prizren)

##### Audienca

Rreth 50

#### Disa konkluzione dhe opinione themelore të debatit

**Limani:** Prizreni me shumë pasuri të trashëgimisë kulturore por nga ky fakt nuk po përfiton komuna e prizrenit. Këtë e vërtetojmë se në Prizren gjatë ditëve të vikendit nuk punojnë muzetë, as Lidhja e Prizrenit e as Muzeu Arkeologjikë. Në vendet përfundimtare vikendi është koha kur më së shumti vizitohen muzet dhe nga gjenerojnë të hyra. Për të zhvilluar këtë komponent shumë të rëndësishme "kulturizmin" organet komunale duhet të kenë një menaxhment më të mirë dhe më funksional. Shenjëzimi është edhe një faktor tjetër i cili ndikon në mos promovimin e objekteve të vjetra me shumë vlerë kulturore. Shenjëzimi nuk është edhe aq i shtrenjtë, këtu më së shumti nevojitet vullneti i mirë politik që një gjë e tillë të ndodh. Me një shenjëzim të mirëfillt të objekteve Prizreni do të përfitonte shumë. Faktori tjetër që është i



ndërlidhur me shënjzimin është edhe ndriqimi i objekteve edhe ky është një segment shumë i rëndësishëm për promovimin e objekteve të vjetra që kanë pasuri shumë të mëdha kulturore.

**Nurkollari:** Dokufest nuk përkrahët nga Komuna në atë nivel në të cilin e meriton ky institucion. Dokufest gjatë javës së realizimit komunës i bjenë shumë të ardhura si ekonomike ashtu edhe kulturore. Dokufest nga shuma të cilën e merr nga komuna 10 herë më shumë ia kthen komunës pasi që javën që realizohet festivali, pjesmarrësit si vendor ashtu edhe ndërkombëtar lënë një shumë të konsideruar të parave në qytetin e Prizrenit. Dokufest nuk e ka përkrahjen e nevojshme nga organet komunale. Dokufest 10 herë më shumë se nga që i jepet i bjenë komunës. Po nëse komuna do të rrit buxhetin për festivalin dokumentar edhe Dokufest do të ia rrit të ardhurat komunës gjatë javës së realizimit të festivalit. Nëse sot komuna e jep një e i merr 10, nëse në të ardhmen do t'i jepte 10 do të mund t'i merrte 100. Të gjithë e dijme se Prizreni është qytet i vjetër por i cili çdo ditë po degradohet. Shënjzimi dhe ndriqimi do të luanin rol shumë të rëndësishëm në promovimin e kulturës të këtij qyteti por organet komunale janë treguar injorante deri më sot dhe se nuk kanë bërë një gjë të tillë e cila besoj se nuk ka të bëjë me kompetencat e rezervuara të komunës.

**Bushati:** Artizanatet janë të diskriminuara pasi që tatimi i lart shumicën prej tyre i detyron të mbyllën. Në si shoqatë e artizanatëve të Prizrenit kërkojmë që të ndërtohet një qendër ku janë të prëfshira të gjitha artizanatet e vjetra si, sahatçi, kallajxhi, etj. Dhe këtyre artizanatëve të ju krijohen lehtësira sa i përket tatimit. Pra të jenë të privileguara si pasuri të vjetra të një qyteti të vjetër.

## PRERA 2 - Kulturimi

**Bajrami:** Ministria e Tregtisë dhe Industrisë-ka filluar me një projekt rajonal sa i përket zhvillimit të turizmit. Ky projekt zhvillohet në disa zona të dukagjinit, në Shqipërinë Veriore si dhe me Malin e Zi. Ky projekt tani është në fazën fillestare dhe se është duke u hartuar strategjia e zhvillimit të këtij turizmi. Gjithashtu është krijuar një komision që përfaqësohet nga të gjitha shtetet e përfshira, ku ky komision është duke punuar më një intezitet të lartë për të hartuar këtë strategji të zhvillimit të turizmit. Zyra për Turizëm që është pjesë e ministrisë së tregtisë dhe industrisë nuk ka ndonjë buxhet të lartë që të zhvillojë turizmit në Kosovë, por me këto kapacitete po mundohet të kontribuoj zhvillimit të turizmit në Kosovë. Gjithashtu zyra jonë ka bërë një web-faqe sa i përket promovimit të turizmit në Kosovë,por për shkaqe teknike kjo faqe tash është tërhekur nga përdorimi dhe presim që shumë shpejt të rifunksionalizohet, pasi që kemi pasur komente të mira lidhur me këtë web-faqe.

### Metodologjia

Për qëllime të kësaj studimi është përdorur metoda e hulumtimit kuantitativ ku si instrument kërkues është një pyetje standardizuar që në vete ngërthen pyetje bazë për të matur njohuritë e qytetarëve të fshatit mbi gjendjen aktuale të trashëgimisë kulturore të fshatit si dhe potencialin e zhvillimit të turizmit kulturor bazuar në vlerat dhe pasuritë kulturore (të të trashëgimisë kulturore) të cilat i posedojnë fshatit. Në mostrën e hulumtimit janë përfshirë gjithsej 200 qytetorë me qytetësi të fshatit (përndje statistikisht sipërkohëse) dhe hulumtimit i është shtruar edhe një sub-mostrë prej 50 qytetorëve që përfshijn tri target grupe me interes të veçantë në qytetin e fshatit: komunitetin e biznesit, qytetarët e kullës së komunalit të fshatit dhe organizatat e shoqërisë civile.

Në hulumtim janë përfshirë qytetarë nga mostra 16-60 vjeç, me ndje 95% qytetarë dhe 5% fshat. 58.5% të qytetarëve maskulinë dhe 41.5% të qytetarëve femërorë. Përqendrimi i analizave statistikore është rezultat me softuerin SPSS 14 (Statistical Package for Social Science).

Tabela 1: Karakteristika demografike dhe kulturore të qytetarëve të fshatit	
Qytetarë n=200	Komuniteti i biznesit n=30
Qytetarë të Kullës së Komunalit n=12	Organizata të shoqërisë civile n=12
Vetë-vlerësimet demografike	
52% qytetarë	28.5% meshkuj
39% fshat	41.5% femërorë

## **PJESA 2 – Hulumtimi**

### **Turizmi kulturor, mundësi për zhvillim lokal ekonomik**

*Hulumtim mbi gjendjen e trashëgimisë kulturore dhe vlerësimin e potencialit për zhvillimin e turizmit kulturore në Prizren*

Krijimi dhe promovimi i kulturës së debatit është parakusht themelor i inicimit të partneritetit afatgjatë mes qeverisë lokale dhe qytetarëve në drejtim të krijimit dhe implementimit të politikave dhe projekteve me interes të përgjithshëm në qytetin e Prizrenit. Në këtë kuadër Organizata Joqeveritare EC Ma Ndryshe ka iniciuar një hulumtim kuantitativ mbi Trashëgiminë Kulturore në Prizren ku si qëllim është njohja më e afërt e situatës së Trashëgimisë Kulturore të qytetit nga ana e qytetarëve të saj e gjithashtu nga ana e komunitetit të biznesit që kanë një rol të rëndësishëm mbi kultivimin e turizmit kulturor, si dhe nga zyrtarët komunal të departamentit që kanë të bëjnë me mbrojtjen e trashëgimisë kulturore. Rezultatet e këtij studimi pasqyrojnë bindjet dhe perceptimet e tyre mbi çështjen e trashëgimisë kulturore ku qytetarët, bizneset, dhe zyrtarët komunal iu janë përgjigjur një pyetësori të standardizuar.

### **Metodologjia**

Për qëllime të këtij studimi është përdorur metoda e hulumtimit kuantitativ ku si instrument kryesor është një pyetësori i standardizuar që në vete ngërthen pyetje bazë për të matur njohuritë e qytetarëve të Prizrenit mbi gjendjen aktuale të trashëgimisë kulturore të Prizrenit si dhe potencialin e zhvillimit të turizmit kulturor bazuar në vlerat dhe pasuritë kulturore (dhe të trashëgimisë kulturore) të cilat i posedon Prizreni. Në mostrën e hulumtimit janë përfshirë gjithsej 200 pyetësorë me qytetarët e Prizrenit (përqindje statistikisht sinjifikante), derisa hulumtimit i'u është shtuar edhe një sub-mostër prej 60 pyetësorëve që përfshin tri target grupe me interes të veçantë në qytetin e Prizrenit, komunitetin e biznesit, zyrtarët e Kuvendit Komunal të Prizrenit dhe organizatat e shoqërisë civile.

Në hulumtim janë përfshirë qytetarë nga mosha 16-60 vjet, me ndarje 95% qytet dhe 5% fshat, 58.5% të gjinisë mashkullore dhe 41.5% të gjinisë femërore. Përpunimi i analizave statistikore është realizuar me softuerin SPSS 14 (Statistical Package for Social Science).

<b>Total pyetësor n= 260</b>	
Qytetarë n=200	Komuniteti i biznesit n=30
Zyrtarë të Kuvendit Komunal n=15	Organizata të shoqërisë civile n=15
Ndarja demografike.	
95% qytet	58.5% meshkuj
5% fshat	41.5% femra

### Analizë, përgjigjet e qytetarëve


Qyteti i Prizrenit ka ndryshuar viteve të fundit dhe ky rezultat ka ndikuar në mënyra të ndryshme opinionin e qytetarëve të këtushëm. Ndryshimet kanë reflektuar edhe në pikëpamjet rreth kënaqësisë momentale të qytetarëve mbi trashëgiminë kulturore. Përgjigjet e dhëna në këtë pyetje tregojnë një grup të përafërt të qytetarëve të cilët janë të kënaqur me grupin që nuk janë të kënaqur me situatën e tanishme të trashëgimisë kulturore në Prizren. Por, shqetësuese është shifra prej 53.3 % të respondentëve, të cilët nuk janë të vendosur për përgjegjen e tyre. Kjo shumicë e njerëzve të pavendosur tregon për një mungesë të madhe informacioni, respektivisht mungesë komunikimi në mes të qytetarëve dhe organeve komunale. Derisa shumica janë të pavendosur, 1.9% e qytetarëve të Prizrenit shprehin se janë shumë të kënaqur, ndërsa 20.8% të tyre janë të kënaqur me situatën e tanishme të trashëgimisë kulturore, derisa 18.9 % janë të pakënaqur dhe 3.9% janë totalisht të pakënaqur. Shih tabelën 1

Tabela 1

#### C1 Sa jeni të kënaqur me situatën e tanishme të trashëgimisë kulturore në Prizren?

	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
1 Shumë i kënaqur	5	1.9	1.9	1.9
2 I kënaqur	54	20.8	20.8	22.8
3 Deri diku i kënaqur	138	53.1	53.3	76.1
Valid 4 I pakënaqur	49	18.8	18.9	95.0
5 Aspak i kënaqur	10	3.8	3.9	98.8
6 Pa përgjigje	3	1.2	1.2	100.0
Total	259	99.6	100.0	
Missing System	1	.4		
Total	260	100.0		

- Shumë I kënaqur
- I kënaqur
- As I kënaqur as I pakënaqur
- I pakënaqur
- Aspak I kënaqur
- Pa përgjigje



Në pyetjen se sa e njihni në përgjithësi trashëgiminë kulturore të Prizrenit shumica e qytetarëve shprehin pozitivisht: rreth 79% të tyre kanë njohuri mbi objektet e trashëgimisë së qytetit të Prizrenit dhe vetëm 21% e tyre e kanë pak apo aspak njohuri rreth trashëgimisë së tyre.

Rreth objekteve që qytetarët kanë më së shumti njohuri dhe që janë pjesë e trashëgimisë kulturore të vendit të tyre janë:


1. Lidhja e Prizrenit
2. Hamami
3. Kalaja
4. Ura e gurit
5. Sinan Pasha
6. Xhuma Xhamia

Vetëkritika nga ana e qytetarëve të Prizrenit nuk mungon sa i përket trashëgimisë kulturore. Një pjesë e madhe konsiderojnë se vet ata nuk janë në mbrojtje të këtyre vlerave. Në pyetjen se qytetarët e Prizrenit kujdesen mjaft mbi trashëgimin kulturore të vendit të tyre gati gjysma e respondentëve 45% pajtohen më këtë konkluzion ndërsa 47% e tyre janë pjesë e qytetarëve vetëkritik. shih tabelën 2

Tabela 2

**C5 Qytetarët e Prizrenit kujdesen mjaft për trashëgimin kulturore të vendit të tyre?**

	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
1 Pajtohem plotësisht	6	2.3	2.3	2.3
2 Pajtohem	110	42.3	42.6	45.0
3 Nuk pajtohem	105	40.4	40.7	85.7
Valid 4 Aspak nuk pajtohem	18	6.9	7.0	92.6
5 Nuk di	17	6.5	6.6	99.2
6 Pa përgjigje	2	.8	.8	100.0
Total	258	99.2	100.0	
Missing System	2	.8		
Total	260	100.0		




Konstatimin e vetëkritikës e mbështesin gjithashtu edhe rezultatet e pyetjes pasuese se sa ata vet kujdesen mbi trashëgiminë kulturore të vendit të tyre. 64% të tyre e konsiderojnë kujdesin e tyre që të pakët, ndërsa 22% të tyre konsiderojnë se aspak nuk kujdesen mbi vlerat e qytetit të tyre. Vetëm 13.9 veten e vlerësojnë si shumë të kujdesshëm. shih tabelën 3

*Tabela 3*

**C6 Sa kontribuoni personalisht ne mbrojtjen dhe promovimin e Trashëgimisë Kulturore te Prizrenit?**

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1 Shumë	36	13.8	13.9	13.9
	2 Pak	166	63.8	64.1	78.0
	3, Aspak	57	21.9	22.0	100.0
	Total	259	99.6	100.0	
Missing	System	1	.4		
Total		260	100.0		



Roli i qytetarëve të Prizrenit në ruajtjen dhe kujdesin e trashëgimisë kulturore është i shumtë, gjithashtu edhe pikëpamjet e respondentëve janë të ndryshëm por ato që duhen të cekën janë: Bashkëpunimi i qytetarëve dhe zyrtarëve komunal mbi kujdesin e përbashkët të trashëgimisë kulturore, investimet e vet qytetarëve për renovimin dhe kujdesin e vlerave të qytetit, sensibilizim i gjithëmbarshtëm të qytetarëve mbi vlerat e qytetit, organizim periodik për pastrimin e qytetit, shpërndarja e broshurave se si kujdeset për monumente dhe organizime të debateve me qytetar, etj. Këto janë disa nga pikëpamjet më të shpeshta të respondentëve se si ata mund ta

shohin veten e tyre në ruajtjen dhe kujdesin më të mirë të trashëgimisë kulturore të Prizrenit.

Në këtë kuadër respondentët gjithashtu shprehin opinionet e tyre rreth rolit të Kuvendit Komunal mbi trashëgimisë kulturore. Rezultatet tregojnë se 12% janë të kënaqur më punën e Kuvendit Komunal (KK), 37.6% janë të pakënaqur. Gjithashtu mbeten shqetësuese përgjigjet e qytetarëve që konsiderojnë veten e tyre si neutral (48.1%) Shih tabelën 4.

Gjithashtu kur bëhet fjalë kujdesin ndaj trashëgimisë kulturore të Prizrenit nga ana e institucioneve më të larta qeveritare, qytetarët po në të njëjtën mënyrë përgjigjen pra që shumica e tyre nuk kanë një orientim të qartë. 10.8% e tyre konsiderojnë se kujdesi nga ana e qeverisë është i kënaqshëm, 30.1% konsiderojnë se kujdesi është shumë i pakënaqshëm, dhe 53.7% janë të pavendosur dhe shprehin veten si neutral. Shih tabelën 5.

“Përqindja e madhe e qytetarëve të cilët nuk kanë mendim të definuar, sidomos sa i përket institucioneve lokale dhe qendrore, mund të vijë si rezultat i ndërrimit të partisë në pushtet si në nivelin lokal ashtu edhe në atë qendror. Koha e shkurtër prej ndërrimit të pushtetit deri te kjo analizë, mund të jetë arsye për mungesë vlerësimi për pushtetin e ri.”

Tabela 4

C4 Sa jeni të kënaqur me mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore nga ana e Kuvendit Komunal dhe institucioneve tjera zyrtare?

	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
1 Shumë i kënaqur	4	1.5	1.6	1.6
2 I kënaqur	27	10.4	10.5	12.0
3 As i kënaqur as i pakënaqur	124	47.7	48.1	60.1
4 I pakënaqur	69	26.5	26.7	86.8
5 Aspak i kënaqur	28	10.8	10.9	97.7
6 Pa përgjigje	6	2.3	2.3	100.0
Total	258	99.2	100.0	
Missing System	2	.8		
Total	260	100.0		







Tabela 5

**C7 Sa jeni të kënaqur me punën e Qeverisë së Republikës së Kosovës mbi mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore në Prizren?**

	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid 1 Shumë i kënaqur	2	.8	.8	.8
2 I kënaqur	26	10.0	10.0	10.8
3 As i kënaqur as i pakënaqur	139	53.5	53.7	64.5
4 I pakënaqur	57	21.9	22.0	86.5
5 Aspak i kënaqur	21	8.1	8.1	94.6
6 Pa përgjigje	14	5.4	5.4	100.0
Total	259	99.6	100.0	
Missing System	1	.4		
Total	260	100.0		

- Shumë I kënaqur
- I kënaqur
- As I kënaqur as I pakënaqur
- I pakënaqur
- Aspak I kënaqur
- Pa përgjigje



Turizmi në qytetin e Prizrenit ka një rol të rëndësishëm gjithashtu në zhvillimin e qytetit. Duke ditur se Prizreni posedon një pasuri më të madhe kulturore shumë nga qytetarët e pjesëve tjera të Kosovës dhe më gjërë vizitojnë rregullisht monumente historike me vlera të mëdha kulturore.


Bizneset në këtë kuadër kanë një rol shumë të madh duke ofruar shërbime relaksuese në të gjitha sferat. Pikëpamjet e tyre për rritje të ofertës turistike janë të ndryshme, ku 39% e tyre konsiderojnë se janë të gatshme për rritje të ofertës turistike, 20.5% konsiderojnë se nuk janë të gatshëm ndërsa 40.5% nuk e dinë se a janë apo nuk janë të gatshëm bizneset për rritje të ofertës turistike. shih tabelën 6

Tabela 6

**C10 A janë bizneset te gatshme per rritje te ofertes turistike?**

	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1 Po	101	38.8	39.0
	2 Jo	53	20.4	59.5
	3 Nuk e di	105	40.4	100.0
	Total	259	99.6	100.0
Missing System	1	.4		
Total	260	100.0		

■ Po ■ Jo ■ Nuk e di



Qytetarë e Prizrenit vlerësojnë se trashëgimia kulturore është prioritet për qytetin e tyre, nëpërmjet turizmit kulturor konsiderohet se mundet që të zhvillohet edhe vet qyteti e posaqërisht të përfitojnë ekonomikisht vet qytetarët. Nga gjithsejt 258 qytetarë, 77.1% e tyre e konsiderojnë se trashëgimia kulturore është prioritet, 7% nuk pajtohen më këtë dhe 15.9% nuk kanë mendim të përcaktuar. shih tabelën 7

Tabela 7

**C8 A është Trashëgimia Kulturore prioritet për Prizrenin?**

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1 Po	199	76.5	77.1	77.1
	2 Jo	18	6.9	7.0	84.1
	3 Nuk e di	41	15.8	15.9	100.0
	Total	258	99.2	100.0	
Missing System		2	.8		
Total		260	100.0		

**Tabulimet**

Në tabelën e mëposhtme paraqiten tabulimet ndërmjet gjinisë dhe pyetjes se sa jeni të kënaqur me situatën e tanishme të trashëgimisë kulturore në Prizren? Këtu shihet një dallim thelbësor të pikëpamjeve të tyre ku më shumë të kënaqur janë gjinia femërore sesa ajo mashkullore. Shih tabelën 7

Tabela 8

**Gjinia e të anketuarit \* C1 Sa jeni të kënaqur me situatën e tanishme të trashëgimisë kulturore në Prizren? Crosstabulation**

	C1 Sa jeni të kënaqur me situatën e tanishme të trashëgimisë kulturore në Prizren?						Total
	1 Shumë i kënaqur	2 I kënaqur	3 Deri diku i kënaqur	4 I pakënaqur	5 Aspak i kënaqur	6 Pa përgjigje	
1 Mashkull	1 20.0%	32 62.7%	68 50.4%	37 77.1%	7 70.0%	2 66.7%	147 58.3%
2 Femër	4 80.0%	19 37.3%	67 49.6%	11 22.9%	3 30.0%	1 33.3%	105 41.7%
Total	5 100.0%	51 100.0%	135 100.0%	48 100.0%	10 100.0%	3 100.0%	252 100.0%

Sa i përket dallimeve në kontribut dhe në mbrojtjen promovimin e trashëgimisë kulturore, siç është paraqitur në tabelën 8, gjinia mashkullore është që të kontribuojë më shumë rreth mbrojtjes dhe promovimit të trashëgimisë kulturore.

Tabela 9

**B1 Gjinia e të anketuarit \* C6 Sa kontribuoni personalisht ne mbrojtjen dhe promovimin e Trashëgimisë Kulturore te Prizrenit? Crosstabulation**

		C6 Sa kontribuoni personalisht ne mbrojtjen dhe promovimin e Trashëgimisë Kulturore te Prizrenit?			Total
		1 Shumë	2 Pak	3 Aspak	
1 Mashkull		24	98	25	147
		66.7%	60.5%	46.3%	58.3%
2 Femër		12	64	29	105
		33.3%	39.5%	53.7%	41.7%
Total		36	162	54	252
		100.0%	100.0%	100.0%	100.0%

Si prioritet i qytetit, trashëgimia kulturore dominon te meshkujt, në krahasim me femrat. Në përgjithësi, në bazë të kësaj analize, del se meshkujt janë më të preokupuar me çështjen e trashëgimisë kulturore.

Tabela 10

**B1 Gjinia e të anketuarit \* C8 A është Trashëgimia Kulturore prioritet për Prizrenin? Crosstabulation**

		C8 A është Trashëgimia Kulturore prioritet për Prizrenin?			Total
		1 Po	2 Jo	3 Nuk e di	
1 Mashkull		121	10	15	146
		62.1%	58.8%	38.5%	58.2%
2 Femër		74	7	24	105
		37.9%	41.2%	61.5%	41.8%
Total		195	17	39	251
		100.0%	100.0%	100.0%	100.0%

## Përfundim

Në bazë të studimit shihet se ekziston një vakum ndërmjet komunikimit të qytetarëve dhe zyrtarëve komunal ku si pasojë në të shumtën e rasteve qytetarët janë të hutuar rreth çështjes së trashëgimisë së tyre dhe nuk kanë një orientim të qartë. Megjithatë është e qartë se pakënaqësitë janë evidente dhe pa marrë parasysh gjithë situatën rreth trashëgimisë kulturore, ekziston një vullnet i madh për bashkëpunim me të gjitha institucionet me vullnet të mirë për mbrojtjen dhe kultivimin e trashëgimisë kulturore.

Krijimi i komunikimit sa më të mirë, inkuadrimi sa më shumë i qytetarëve në projekte mbi trashëgiminë kulturore janë disa nga çështjet emergjente rreth së cilave zyrtarët komunal do duhen të veprojnë, çështje këto ku interesi është i gjithëmbarshëm e posaçërisht për qytetarët e Prizrenit.

### **Pjesa 3 - Analiza**

#### **Potenciali i zhvillimit të turizmit kulturor në Prizren – KULTURIZMI<sup>1</sup>**

##### **Hyrje**

Qyteti i Prizrenit njihet si një qytet i vjetër dhe me kulturë të zhvilluar. Gjatë një pjese të madhe të historisë së këtyre anëve, Prizreni ka qenë qendër politike, kulturore dhe shpirtërore. Gërshetimi i kulturave dhe popujve që kanë bashkëjetuar në qytet e kanë pasuruar vazhdimisht traditën dhe trashëgiminë e Prizrenit dhe kanë sjellë në ditët tona një kompleks shumë interesant të objekteve arkitektonike, vlerave kulturore dhe traditave popullore të banorëve të Prizrenit.

Qytetarët, por edhe liderët e Prizrenit, vazhdimisht janë krenuar me këto vlera të trashëguara dhe e kanë emëruar Prizrenin si “kryeqytet kulturor”, emërtim ky i pranuar gjerë edhe në pjesën tjetër të Kosovës. Përkundër kësaj, përveç kënaqësisë shpirtërore, qyteti dhe qytetarët prizrenas thuajse asnjëherë nuk kanë arritur që këtë pasuri ta shndërrojnë në aktivitet zhvillimor dhe përfitues. Edhe pse vazhdimisht kanë ekzistuar iniciativa individuale që potenciali turistik i qytetit të shfrytëzohet edhe për një mirëqenie ekonomike, ato kanë mbetur në nivelin fillestar për shkak të mungesës së një organizimi të mirëfilltë institucional, qytetar dhe shoqëror.

Në kohën kur trendi i turizmit botëror po anon gjithnjë e më tepër nga turizmi tematik (ku pjesën më të madhe e zë kulturizmi), por edhe rajoni ynë në përgjithësi po hyn në një fazë stabiliteti dhe përparimi socio-ekonomik, potenciali kulturistik i Prizrenit paraqet një bazë të shkëlqyeshme për një zhvillim ekonomik lokal të bazuar në institucione mirë të organizuara, politika zhvillimore dhe angazhim të komunitetit.

Përfundimisht po vjen koha që, përveç promovimin patriotik, ligjërit nëpër shkollë, të krenuarit me posedimin e tij, mburrjes sa për t’u mburrur dhe në të njëjtën kohë mosshfrytëzimit praktik të kësaj trashëgimie, të mendohet dhe të ve-

---

<sup>1</sup>Termin KULTURIZËM e përdorim për lehtësim terminologjik dhe si emërues i përbashkët i koncepteve të ndryshme komplementare në këtë fushë: turizmi kulturor, turizmi i lidhur me trashëgimi kulturore, turizmi arkeologjik, turizmi i lidhur me tradita popullore, “feel-good” turizmi, eko-turizmi, etj. Në këtë publikim, por edhe në të gjitha aktivitetet dhe dokumentet e lidhura me EC Ma Ndryshe, KULTURIZMI nënkupton mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore, kulturës artistike dhe traditës popullore në funksion të zhvillimit të turizmit.

prohet në drejtim të materializimit të kësaj trashëgimie, duke e shndërruar Prizrenin në një vend shumë atraktiv turistik, ndërsa trashëgiminë e tij kulturore, në një atraksion të vërtetë turistik që sjell përfitime materiale për qytetarët e Prizrenit. Me një fjalë, esenciale për këtë kohë do të ishte transicioni i butë dhe demokratik nga "trashëgimia kulturore për mburrje" (konsum të brendshëm) në një "trashëgimi kulturore të orientuar kah turizmi".

Në këtë drejtim, hap i parë dhe i dëmosdoshëm del të jetë krijimi i mekanizmave efektivë të propagandës, përmes të cilëve do të synohet arritja deri tek turistët dhe tërheqja e vëmendjes së tyre mbi këtë qytet. Në këtë moment, ndër rolet primare sigurisht se luan kreativiteti i mendjes njerëzore, pasi që, një promovim atraktiv nuk mund të kufizohet vetëm me 7 faqe broshurë dhe një ueb-faqe plot me fotografi të qytetit, por kërkon punë shumë intensive dhe kreative për të gjetur mënyra nga më të ndryshmet për ta krijuar këtë urë lidhëse mes qytetit të Prizrenit dhe turistëve potencialë.

Turizëm kulturor do të thotë të shfrytëzosh (utilizosh) resurset natyrore në një mënyrë më ndryshe.

### **Koncepti i Kulturizmit (beneficioni i dyfishtë)**

Trashëgimia kulturore, kultura artistike dhe tradita popullore vetëm si të tilla janë vlera të cilat e karakterizojnë një grup të caktuar të njerëzve apo territor të caktuar, vlera të cilat trashëgohen nga gjeneratat e kaluara, mirëmbahen nga gjenerata aktuale dhe u përcillen gjeneratave të ardhshme. Turizmi kulturor është bërje e vizitës për t'i parë vendet dhe aktivitetet që në mënyrë autentike përfaqësojnë tregimet e njerëzve për të kaluarën dhe të tashmen dhe përfshin atraksionet historike, kulturore dhe natyrore të një vendi.

Gjithashtu, turizmi kulturor përfshin turizmin në zona urbane, posaçërisht në qytete historike dhe objektet e tyre kulturore (muzetë, teatrot, objektet fetare, pasuritë arkeologjike, etj.), si dhe në zona rurale që shquhen me tradita të pasura të komuniteteve lokale (festivale, rituale, vlerat dhe mënyrë e jetesës).

Turizmi kulturor ndodh kur pjesëmarrja në një përvojë kulturore, edukative, ose të trashëgimisë është faktor sinjifikant i një udhëtimi (vizite). Këtu përfshihen: muzetë dhe galeritë, artet performuese, letrare dhe vizuele, festivalet dhe spektaklet tjera, objektet historike dhe atraksionet e trashëgimisë, dhe traditat lokale e kuzhina.

Nevoja për zhvillim ekonomik lokal të Prizrenit, si dhe domosdoshmëria e ruajtjes

së vlerave të trashëgimisë kulturore të qytetit takohen në konceptin e Kulturizmit dhe beneficionit të dyfishtë që sjell kjo qasje. Pasuria kulturore e Prizrenit (objektet e trashëgimisë kulturore, traditat kulturore, zejtaria tradicionale, kuzhina tradicionale, tradita artistike dhe muzikore, multilingualiteti e shumë të tjera) është një potencial shumë i vlefshëm për zhvillimin lokal ekonomik të qytetit. Kjo pasuri, në rast se shfrytëzohet drejtë dhe me mençuri, krijon bazë të qëndrueshme të ardhurash financiare për shumë familje prizrenase, ndërsa në anën tjetër pasuron edhe buxhetin e Kuvendit Komunal të Prizrenit. Gjenerimi i këtyre të ardhurave do të bëhet nga turistët dhe vizitorët e Prizrenit, atraktivi i të cilëve mund të bëhet vetëm me ngritje të ofertës turistike të qytetit. Kjo ofertë mund të ngrihet vetëm në rast të ruajtjes, kultivimit dhe promovimit të pasurisë kulturore të Prizrenit. Me këtë rast, përveç stimulimit të ekonomisë lokale, Kulturizmi do të ndikonte edhe në mbrojtjen e objekteve të trashëgimisë kulturore dhe kultivimin e vlerave tjera tradicionale dhe kulturore të Prizrenit.

### **Fakte rreth Kulturizmit**

Turizmi kulturor është segmenti me rritje më të shpejtë në tregun e turizmit. Sipas një statistike të Organizatës Botërore të Turizmit, turizmi kulturor shënon rritje vjetore në nivelin 15%, ndërsa 37% i të gjitha udhëtimeve ndërkombëtare përmbajnë në vete një komponentë kulturore. Është përgjithësisht e njohur që turistët kulturor shpenzojnë shumë më tepër se sa turistët standardë. Gati në të gjitha udhëtimet dhe lëvizjet turistike në botë, pa marrë parasysh qëllimin, kohë e veçantë i ndahet vizitës nëpër objekte të kulturës dhe njohjes me pasuritë kulturore të vendit të destinimit. Kjo dinamikë gjithnjë në rritje e turizmit kulturor bën që studiues të ndryshëm të këtij sektori zhvillimor të ekonomisë të konstatojnë se në fakt nuk ka lloje tjera të turizmit, por ekziston vetëm një, turizmi kulturor.

Turistët që shijojnë programet artistike dhe kulturore (turistët kulturor) të Floridas, kanë ndikim më të madh ekonomik në krahasim me turistët në përgjithësi. Secili turist kulturor në Florida shpenzon mesatarisht \$348.84, derisa turisti i zakonshëm shpenzon rreth \$291.16. Shpenzimet e turistëve kulturor në Floridë në vitin 1997 llogariteshin në \$2.9 miliardë. Këto mjete kontribuan në bruto prodhimin shtetëror me gjenerimin e \$5.6 miliardëve, krijimin e 64,000 vende të reja të punës dhe ngritjen e rrogave me \$1.7 miliardë.

Turizmi kulturor gjeneron përfitime ekonomike për ekonomitë lokale sepse vizitorët shpenzojnë të holla për hyrje (nëpër objekte), ushqim dhe pije, transport, karburante, akomodim, e shumë të tjera. Këto shpenzime direkte paraqesin mjete (të holla) të reja për ekonominë lokale dhe stimulojnë krijimin e vendeve të reja të



punës dhe të rritjen e të ardhurave, për faktin se këto të holla qarkullojnë nëpër ekonominë lokale.

Turistët kulturor, në vitin 2004 kanë kaluar rreth 8.7 milionë ditë vizituese në shtetin e Uashingtonit, duke shpenzuar rreth \$72.40 në ditë (për person). Në total, këta turistë gjatë vitit shpenzuan rreth \$630 milionë. Pjesa më e madhe e mjeteve u shpenzuan për akomodim, ushqim dhe pije, dhe në blerjen e gjësendeve të vogla. Këto mjete gjeneruan shitje prej afro \$1.3 miliardëve, stimuluan krijimin e 20,000 vendeve të reja të punës në sektorë të ndryshëm të ekonomisë dhe kontribuuan me \$510 milionë në pagesën e rrogave dhe të ardhurave.

Përshkrimi i një turisti kulturor për përvojën e tij kulturistike: "Sapo u ktheva nga një udhëtim në Britani të Madhe. Gjatë kohës sa isha atje, i bëra gjërat që i bëjnë shumica a Amerikanëve. I vizitova muzetë, kalatë dhe kishat mesjetare. Luajta golf dhe bëra ecje (hiking). I vizitova zonat rurale për të kuptuar karakterin e vërtetë të vendit. I shijova gjellët lokale dhe i hulumtova zejet lokale. U mrekullova nga gjallëria e qyteteve. Unë isha një turist kulturor dhe shpenzova shumë para."

Sipas raportit të Arizona Humanities Council të publikuar rishtazi "Rritja e Ekonomisë së Arizonas duke Investuar në Trashëgimi Kulturor", çdo \$1 milion investim në trashëgimi kulturore ka gjeneruar \$11 milionë ndikim në ekonominë lokale. Sipas këtij studimi, për rreth 80% të udhëtarëve vizita nëpër objekte historike ka prioritet të lartë, ndërsa rreth 45% të turistëve janë të motivuar nga mundësia për përvoja kulturore. Gjithashtu, ky studim dëshmon se turisti kulturor (dhe i trashëgimisë kulturore) shpenzon mbi \$1100 për person më shumë se turisti mesatar, qëndron 9.5 ditë më gjatë dhe ka një tendencë 20% më të madhe për të blerë (shopping). Thënë shkurt, turisti kulturor është ndër faktorët kryesor të industrisë turistike të Arizonas që llogaritet në shumën prej \$10 miliardë.

#### **Çka synohet? Si dhe çka do të përmirësohet?**

Kulturizmi praktikisht paraqet një metodologji tejet efikasi dhe me efekte pozitive në shumë sektorë zhvillimorë. Përmes një mentaliteti ekonomik të orientuar kah turizmi kulturor, Prizreni do të përfitonte në një mori aspekte të ndryshme, duke përfshirë:

- Themelimin dhe forcimin e institucioneve relevante (qeveri lokale, shoqëri civile dhe komunitet i biznesit) të aftë për të facilituar zhvillimin turistik të Prizrenit
- Mobilizimin dhe bashkëpunimin ndërsektoral si parakusht i

domosdoshëm për rritjen e ofertës turistike të Prizrenit

- Mbrojtjen e objekteve të trashëgimisë kulturore dhe pasurisë kulturore të Prizrenit përmes promovimit dhe intervenimit direkt
- Arritjen e vetëdijes së duhur qytetare për përkujdesje dhe trajtim të veçantë ndaj pasurisë kulturore të Prizrenit, si dhe për pjesëmarrje të drejtpërdrejtë në procese shoqërore dhe vendimmarrje politike

Përfitues të drejtpërdrejtë të një politike të këtillë lokale për zhvillim ekonomik do të jenë qytetarët e Prizrenit dhe qyteti i Prizrenit në përgjithësi. Brenda këtij grupi të përgjithshëm, grupet specifike që do të ndikohen drejtpërdrejt nga komponentët e ndryshme të Kulturizmit janë: Institucionet e pushtetit lokal, vendimmarrësit lokalë dhe qendrorë, institucionet kulturore të qytetit, të rinjtë prizrenas të interesuar për trashëgimi kulturore dhe punë vullnetare, komuniteti i zejtarëve dhe artizanëve si dhe organizatat jo-qeveritare vendore dhe ndërkombëtare të fushës së trashëgimisë kulturore, kulturës dhe zhvillimit lokal.

Efektet e dëshiruara të Kulturizmit duhet të arrihet përmes një metodologjie multidisiplinare, në të cilin do të involvohen aktorë relevantë të këtij procesi. Dimensionimi i parë i kësaj ndërhyrjeje konsiston në ndërtimin institucional dhe ngritjen e kapaciteteve të institucioneve ekzistuese dhe atyre që duhet të krijohen (Zyra Turistike, organizatat vullnetare, shoqatat kulturore, klubet e cicero-nëve, etj.). Intervenimi direkt në promovimin dhe ruajtjen e vlerave kulturore, e në radhë të parë të trashëgimisë kulturore të Prizrenit, duhet të jetë pjesë esenciale e procesit. Përmes konservimit dhe restaurimit të objekteve me vlerë të trashëgimisë kulturore të qytetit dhe promovimit aktiv të kësaj pasurie do të krijohen kushte të domosdoshme për ngritjen e ofertës turistike të Prizrenit. I gjithë aktiviteti i zhvillimit të turizmit kulturor në Prizren duhet të posedojë bazë të fortë legjislative dhe politike. Për këtë arsye zhvillimi dhe zbatimi i politikave efektive për intervenim në këto fusha zhvillimore si dhe roli përcaktues i shoqërisë civile në avokim tek qeveria lokale dhe qendrore për krijimin dhe zbatimin e këtyre politikave përbën një hallkë të patjetërsueshme në ngritjen e potencialit dhe ofertës turistike të Prizrenit. I gjithë ky cikël do të ketë kuptim të vërtetë dhe do të prodhojë pasoja të dëshirueshme afatgjatë vetëm nëse në komunitet do të kultivohej shpirti i pjesëmarrjes aktive në ngritjen e ofertës turistike. Fillimisht përmes grupeve vullnetare që do të angazhohen në ruajtjen e vlerave kulturore të qytetit, por edhe përmes inkuadrimin të drejtpërdrejtë të qytetarëve në krijimin e klimës pozitive ndaj vizitorëve, Prizreni do të krijonte një atmosferë mjaft miqësore dhe të ngrohtë për pritjen e vizitorëve.

Përmes këtij procesit Prizreni do të arrijë rritjen dhe institucionalizimin e ofertës turistike, emancipimin qytetar dhe kulturor për vlerat dhe rëndësinë e trashëgimisë kulturore, krijimin e strategjisë gjithëpërfshirëse për zhvillimin e turizmit kulturor dhe në aspekt të përgjithshëm, qyteti do të përjetojë një zhvillim të hovshëm lokal kulturo-ekonomik.

Suksesi i gjithëmbarshtëm i këtij procesi do të matet në bazë të këtyre indikatorëve: [a] Ndërtim institucional dhe ngritje kapacitetesh (hapja dhe funksionalizimi i Zyrës Turistike, ngritja e kapaciteteve të organizatave dhe institucioneve që do të përfshihen në proces, themelimi i organizatave të reja (si Klubi i Ciceronëve), numri i partnerëve të përfshirë në proces dhe aktivitete dhe niveli i bashkëpunimit të ndërsjellë), [b] Mbrojtje dhe promovim të trashëgimisë kulturore (përgatitja dhe publikimi i City Guide, faqes se internetit, materialeve promovuese të shtypura, shenjzimit të objekteve të trashëgimisë kulturore, numri i objekteve të konservuara dhe restauruara), [c] Avokim për politika efektive (numri i dokumenteve politike dhe krijimi i infrastrukturës ligjore për kulturizëm, numri i çështjeve të ngritura të lidhura me Trashëgimi Kulturorë në nivelet vendim-marrëse), si dhe [d] Nxitje të pjesëmarrjes qytetare (numri i vullnetarëve dhe grupeve të vullnetarëve të angazhuar në aktivitetet rreth Trashëgimisë Kulturore, numri i vendeve të punës të lidhura me Trashëgimi Kulturorë, numri i iniciativave nga komuniteti të lidhura me kulturizëm, numri i çështjeve të ngritura dhe efektet institucionale të arritura).

### **Përfituesit**

Përfituesit e kësaj qasjeje duhet të konsiderohen në raport me ndryshimin e perceptimit mbi trashëgiminë kulturore të qytetit dhe lulëzimin e turizmit të qytetit. Në atë rast, përfituese do të jetë ekonomia lokale duke e prekur (ndikuar) në terma të përgjithshëm pozitivisht mirëqenien e përgjithshme të qytetarëve, ndërsa në veçanti do të fitojnë individët dhe familjet dhe komuniteti i biznesit, drejtpërdrejtë të angazhuara në biznese që burim të ardhurash do t'i kenë turistët. I tërë ky ndryshim në qasje, në mënyrë që të mos prodhojë pasoja degraduese për trashëgiminë kulturore të qytetit, do të bëhet paralelisht me një proces të marrjes nën mbrojtje dhe sigurim të objekteve të trashëgimisë kulturore, që nënkupton se edhe vetë objektet e trashëgimisë kulturore do të përfitojnë nga kjo përkujdesje, duke i ikur shkatërrimit dhe degradimit nga neglizhenca dhe moskujdesi institucional dhe qytetar.

Niveli tjetër i përfituesve do të jetë ai institucional. Përveç ngritjes së kapaciteteve të aktorëve të involvuar në këtë proces, do të themelohet disa organizata të reja të shoqërisë civile, të cilat do të janë bartëse të implementimit në faza të caktuara të

zhvillimit të turizmit kulturor në Prizren, duke i ngritur kapacitetet menaxhuese dhe institucionale. Themelimi dhe konsolidimi i Zyrës Turistike të Kuvendit Komunal të Prizrenit, do ta aftësojë qeverinë lokale në ndërmarrje të politikave efektive dhe të mençura si në fushën e trashëgimisë kulturore, po ashtu edhe në promovim të turizmit në Prizren.

Kulturo-ekonomik

## REKOMANDIME

### *Për qeverinë lokale*

Qeveritë Lokale në përgjithësi, e sidomos qeveria aktuale lokale, duhet fillimisht të përcaktohen për pozitën e tyre në raport me Trashëgiminë Kulturore të qytetit të Prizrenit.

Duke besuar që trashëgimia kulturore të jetë të paktën ndër prioritetet kryesore të Komunës së Prizrenit, organet komunale duhet që në një afat sa më të shkurtër të hartojnë një strategji zhvillimore lidhur me trashëgiminë kulturore të qytetit dhe potencialit turistik të tij. Në hartimin e kësaj strategjie duhet të kyqen ekspertë të fushës, shoqëria civile, qytetarë dhe grupet e ndryshme të interesit.

Gjithashtu, Kuvendi Komunal duhet ta kuptojë përgjegjësinë që e ka ndaj trashëgimisë kulturore të Prizrenit, si një ndër vlerat kryesore që e karakterizojnë këtë qytet. Arsyetimet për mungesë kompetencash i bëjnë dëm më së shumti vet qeverisë lokale, e cila në këtë mënyrë automatikisht e eliminon një mundësi të shkëlqyer të zhvillimit ekonomik dhe e zvogëlon dukshëm rëndësinë e qytetit të Prizrenit si të tërë për mbarë Kosovën.

### *Për shoqërinë civile*

Shoqëria Civile e qytetit të Prizrenit, në bashkëpunim me organizatat tjera të shoqërisë civile në Kosovë, duhet të bëjnë presion të vazhdueshëm, si në organet komunale ashtu edhe në qytetarët e Prizrenit, për vetëdijësim rreth rolit të tyre në mbrojtjen dhe promovimin e Trashëgimisë Kulturore të qytetit.

Vetëdijësimi në vetvete, nuk nënkupton fushata të thata propaganduese me informata të caktuara lidhur me temën, por aktivitete konkrete të cilat do të ndikonin që si qytetarët ashtu edhe institucionet qeveritare të kuptojnë potencialin e qytetit lidhur me trashëgiminë kulturore të tij.

Gjithashtu, organizatat e shoqërisë civile nuk duhet ta shohin veten vetëm si aktorë pasive të zhvillimeve në qytet, por duhet të kenë rol aktiv, sidomos gjatë hartimit të politikave zhvillimore të qytetit. Nismat konkrete të dala nga shoqëria civile do të ishin ndihmesë e madhe për Kuvendin Komunal, me qëllim të afrimit të politikbërjes me qytetarin.

### *Për komunitetin e biznesit*

Në mënyrë indirekte, përfituesi më i madh nga aktivitetet që lidhen me trashëgiminë kulturore të Prizrenit, e sidomos nga zhvillimi i turizmit kulturor, do të ishte komuniteti i biznesit. Turizmi kulturor në vete ngerthen një sistem të tërë shërbimesh, të cilat duhet të kryhen nga bizneset lokale. Kjo paraqet një terren të shkëlqyeshëm për ushtrimin e aktiviteteve të tyre dhe zhvillimin ekonomik lokal në përgjithësi.

Bizneset duhet të jenë shumë më të organizuara, koordinuara dhe bashkëpunuese në marrjen e këtij roli dhe në parim, duhet të përkrahin dhe zhvillojnë idetë të cilat përfundimisht gjenerojnë aktivitete fitimprurëse për qytetin në përgjithësi, dhe bizneset e tyre në veçanti.

### *Për qeverinë qendrore*

Qeveria e Kosovës, duke pasur parasysh që rajoni i Prizrenit (sikurse edhe vet qyteti) është i dyti në Kosovë për nga madhësia dhe popullsia, duhet të rrisin angazhimin e tyre në çështjet që janë të lidhura me këtë qytet.

Për më tepër, duke qenë se qyteti i Prizrenit konsiderohet si "qytet muze i Kosovës", nga Qeveria e Kosovës duhet të zhvillohet një qasje e veçantë ndaj trashëgimisë kulturore të këtij qyteti.

Potenciali i zhvillimit ekonomik nga turizmi kulturor duhet t'i shërbejë Qeverisë së Kosovës si një mjet lehtësues për realizimin e politikave të saja zhvillimore. Decentralizimi i zhvillimit, në këtë rast nëpërmjet turizmit kulturor, duhet të ketë përkrahje të plotë nga qeveria qendrore, si nëpërmjet ndihmës financiare ashtu edhe nëpërmjet hartimit dhe zbatimit të politikave zhvillimore. Bashkëpunimi me Qeverinë Lokale është i një rëndësie të veçantë për përmbushjen e këtyre rekomandimeve.

### *Për donatorët*

Donatorët, sidomos ata ndërkombëtarë, duhet të konsultohen më shumë me vet përfituesit e donacioneve të tyre, në mënyrë që ndihma të shfrytëzohet për nevojat reale të komunitetit. Përcaktimi i fushave dhe sasisë së donacioneve duhet të bëhet në bashkëpunim të ngushtë me grupet e interesit, përfshirë këtu Qeverinë Lokale dhe shoqërinë civile të qytetit.

Për më tepër, depolitizimi i donacioneve të lidhura me trashëgiminë kulturore, do

të ishte një hap përpara për ngritjen e nivelit të pjesëmarrjes së përgjithshme në implementimin e aktiviteteve të financuara nga këta donatorë.

Përfundimisht, prioritet duhet t'i jipen aktiviteteve zhvillimore që garantojnë qëndrueshmëri, në krahasim me aktivitetet afat-shkurtëra të cilat mund të jenë më pak të kushtueshme, por efektet e të cilave zbehen dhe zhduken pas një periudhe shumë të shkurtër.